



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Manifestimi “Takimet e Poeteshave Shqiptare”

Njoftim për shtyp

Vushtrria mbledh poetet shqiptare të të gjitha trojeve

Në një konkurrencë të fortë të 84 poetëve për manifestimin tashmë tradicional “Takimet e Poeteshave Shqiptare” që me 28 dhe 29 maj do të mbahet në Vushtrri, komisioni për vlerësimin e poezive ka përzgjedhur 34 poetë.

Pjesëmarrjen në këtë vend takim të veçantë për poezi, e kanë konfirmuar poetë që tani kanë lënë gjurmë në poezinë shqipe si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri por edhe vende tjera të Evropës perëndimore ku jetojnë bashkatdhetarët.

Në konkurrencë për tri çmimet kryesore janë poetet Kozeta Zavalani Korçë jeton në Tiranë, Sebahate Byci gjakovare jeton në Gjermani, Meri Lalaj Pogradec, Mirlindë Koxha Ferizaj, Mimoza Sali Itali, Mariklena Niço Korçë, Sevëme Fetiçi poete vushtrriase jeton në Gjermani, Punëtorie Ziba e lindur në Strugë jeton në Shkup, Jozefina Traboini Shkodër, Vera Istrefaj Kukës, Lulzana Pajaziti Gjilan, Vera Istrefaj Kukes, Zana Pira Viti, Kozeta Bulla e lindur në Vlorë jeton në Tiranë, Sanije Ahmeti – Dubova Kastriot, Alma Papamihaili e lindur në Tiranë jeton në Gjermani, Vjollca Dibra Prishtinë, Anila Mihali Përmet, Fatime Pllana Kastriot, Marjela Manga Kukës, Hasije Selishta e lindur në Dardanë jeton në Prishtinë, Kejdi Sejdiu Durrës, Miradije Ramiqi Prishtinë, Vilheme Vranari Haxhiraj Vlorë, Remzije Zekolli Vushtrri, Lisiana Demiraj Pogradec, Afërdita Imeri Prishtinë, Sadije Aliti Tetovë, Sherife Thaçi Therandë, Shqiponjë Duro jeton në Belgjikë, Fatime Ahmeti Prishtinë, Violeta Allmuça Dibër jeton në Tiranë, Ganimete Podvorica Prishtinë, Fatime Kulli Durrës dhe Shqipe Hasani Prishtinë.

Komisioni për vlerësimin e poezive konstaton një cilësi të poezive që kanë konkurruar, por edhe një përfaqësim nga hapësira mbarë kombëtare këtë vit. Këtë vit ka një prurje të poezisë më të mirën që nga themelimi i këtyre takimeve, vlerëson shkrimtari Bedri Tahiri nga komisioni përzgjedhës i poezive konkurruese të TPSH që për të 28 herë me radhë mbahen në Vushtrri.

Përveç orës kryesore letrare që do të mbahet me 28 maj, gjatë këtij manifestimi janë paraparë edhe aktivitete tjera si vizita e poeteve në kompleksin Adem Jashari në Prekaz, si dhe tribunën letrare që do të mbahet në ditën e dytë të takimeve.

Organizatore e këtij manifestimi është Komuna e Vushtrrisë në Bashkpunim me Lidhjen e Shkrimtarëve, e mbështetur nga Ministria e Kulturës e Qeverisë së Kosovës. Mbajtjen e manifestimit e ka mbështetur edhe PTK-ja.

Këshilli organizativ,
Vushtrri 21.05.2010